

## SHTOJCË

**Programet sintetike të lëndëve profesionale për të cilat do të hartohen materialet mësimore:**

### **1. Programi i Lëndës**

#### **“Riprodhimi i kafshëve”**

**(L-19-085-16)**

#### **• Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 11 - 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të riprodhimit të kafshëve dhe ndërtimin anatomik të organeve gjinorë femërorë.
- Të përshkruajnë funksionin e ndërtimit të organeve gjinorë femërorë në kafshë të ndryshme.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe fiziologjinë e gjirit të lopët dhe veçoritë anatomike të gjirit të kafshët e tjera bujqësorë.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe fiziologjinë e të organeve gjinorë mashkullorë të kafshët e ndryshme.
- Të tregojnë e diferencojnë kuptimin e pjekurisë seksuale dhe asaj truporë.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit dhe pjekjes së qelizës seksuale femërorë dhe mashkullorë.
- Të përshkruajnë ciklin seksual dhe periudhat e tij.
- Të dallojnë trupin e verdhë të ciklit seksual (periodik) nga ai i mbarsmërisë.
- Të theksojnë karakteristikat e ciklit seksual të kafshët bujqësorë.
- Të përshkruajnë hormonet që marrin pjesë në rregullimin e ciklit seksual dhe ndryshimet e organeve gjinorë tek kafshët në afsh.
- Të përkufizojnë sinkronizimin e afshit.
- Të tregojnë si realizohet sinkronizimi i afshit tek kafshët.
- Të përshkruajnë ndërzimin dhe rëndësinë praktike të njohjes së reflekseve seksuale.
- Të përshkruajnë mënyrat e ndërzimit dhe periudhat e procesit të pllenimit.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit embrional, funksionet e cipave të frytit dhe placentës, ndryshimet anatomike dhe fiziologjike të kafshët barsë, si dhe zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë pozicionin e mitrës të lopët në muaj të ndryshëm të mbarsmërisë.
- Të tregojnë kujdesin për kafshën barse.
- Të përshkruajnë fazat e procesit të pjelljes, shkaqet, shenjat paralajmëruese të saj.
- Të tregojnë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes.
- Të përshkruajnë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe trajtimin e të porsalindurve.

#### **■ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 11 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Rëndësia dhe objekti i riprodhimit të kafshëve	2 orë
<b>Tema 2</b>	Fiziologjia e organeve femërorë gjinorë	6 orë
<b>Tema 3</b>	Fiziologjia e gjirit	6 orë

<b>Tema 4</b>	Fiziologjia e organeve gjinorë mashkullore	6 orë
<b>Tema 5</b>	Pjekuria seksuale dhe truporë	6 orë
<b>Tema 6</b>	Cikli seksual	10 orë
<b>Tema 7</b>	Ndërzimi dhe pllenimi i kafshëve	10 orë
<b>Tema 8</b>	Mbarsmëria	10 orë
<b>Tema 9</b>	Pjelljet te kafshët bujqësore	10 orë
<b>Tema 10</b>	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve pas pjelljes	6 orë

## **2. Programi i Lëndës**

### **“Mbrojtje e kulturave drufrutore” (L-14-174-10)**

- **Synimet e lëndës “Mbrojtje e kulturave drufrutore”, kl. 12 - 34 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Mbrojtje e kulturave drufrutore”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë rolin, qëllimin dhe rëndësinë e mbrojtjes së kulturave drufrutore në vendin tonë.
- të përkufizojnë ç’është sëmundja në bimët bujqësore.
- të përshkruajnë mënyrat e përhapjes së sëmundjeve dhe dëmet që sjellin ato në kulturave drufrutore.
- të theksojnë shkaktarët e sëmundjeve në kulturat drufrutorë.
- të tregojnë ç’janë viruset dhe tiparet e sëmundjeve virusale.
- të tregojnë ndërtimin e bakterieve dhe tiparet e sëmundjeve bakterore.
- të përshkruajnë kërpudhat fitopatogjene dhe mënyrat e shumëzimit të tyre.
- të përshkruajnë si zhvillohet procesi patologjik dhe ndryshimet që pëson bima e sëmurë.
- të emërtojnë dëmtuesit kryesorë të kulturave drufrutorëve.
- të përshkruajnë llojin e dëmit që sjellin dëmtuesit e ndryshëm.
- të llogarisin dëmin që shkaktojnë dëmtuesit në drufrutorët.
- të përshkruajnë tipet e aparatit gojor tek insektet.
- të theksojnë metodat e luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- të përshkruajnë mënyrat e zbatimit të metodës agroteknike të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- të përshkruajnë metodat fizike, mekanike, biologjike dhe të integruar të luftës ndaj sëmundjeve e dëmtuesve.
- të përshkruajnë ç’janë pesticidet dhe grupet kryesore të tyre.
- të përshkruajnë cilësitë që duhet të kenë pesticidet dhe rregullat e përdorimit të tyre.
- të përshkruajnë sëmundjet kryesore që prekin kulturat drufrutore dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- të përshkruajnë dëmtuesit kryesorë të drufrutorëve dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- të tregojnë simptomat e dëmit nga sëmundjet e dëmtuesit në drufrutorët.
- të programojnë masa të luftës së integruar për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtonjësve të ndryshëm.
- të theksojnë mënyrën e përgatitjes së solucioneve (tretësira), me pesticide të përshtatshme për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtonjësve të ndryshëm.

- të theksojnë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë personave të intoksikuar nga pakujdesia gjatë përgatitjes dhe përdorimit të pesticideve.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtje e kulturave drufrutore”, kl 12 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Dëmet që shkaktojnë sëmundjet e kulturave drufrutore	5 orë
<b>Tema 2</b>	Dëmet që shkaktojnë dëmtuesit e kulturave drufrutore	5 orë
<b>Tema 3</b>	Metodat e luftimit të sëmundjeve e dëmtonjësve	6 orë
<b>Tema 4</b>	Sëmundjet kryesore të pemëve frutore.	5 orë
<b>Tema 5</b>	Sëmundjet kryesore të agrumeve dhe ullirit	4 orë
<b>Tema 6</b>	Dëmtuesit kryesorë të pemëve frutore, agrumeve, ullirit	6 orë
<b>Tema 7</b>	Sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të hardhisë	3 orë

### 3. Programi i lëndës

#### “Njohuri për lëkurën” (L-10-433-16)

- **Synimet e lëndës “Njohuri për lëkurën” kl. 12 - 68 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për lëkurën”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të listojnë vetitë e përgjithëshme të lëndëve të para dhe materjaleve ndihmëse të lëkurës për galanteri
- Të argumentojnë rëndësinë e operacioneve mekanike, fizike dhe kimike që kryhen për përpunimin e lëkurave natyrale
- Të listojnë lëkurat e pa përpunuara sipas origjinës
- Të përshkruajnë rëndësinë e proceseve të përpunimit të lëkurës për galanteri
- Të përshkruajnë llojet dhe rëndësinë e klasifikimit të lëkurave tregtare
- Të listojnë vetitë e lëkurëve tregtare sipas funksionit që kryejnë në galanteri
- Të përshkruajnë proceset e përfutimit të materialeve prej lëkure (kamosh, pelice, ilustrinë, etj).
- Të dallojnë me anë të shikimit dhe prekjes karakteristikat e lëkurës
- Të interpretojnë mënyrat e përfutimit të peliçes nga lloje të ndryshme kafshësh
- Të listojnë vetitë e lëkurëve artificiale dhe sintetike
- Të përshkruajnë ndryshimet ndërmjet lëkurave tregtare dhe atyre artificiale e sintetike.
- Të shpjegojnë përdorimet e masave plastike dhe të gomës në galanteri
- Të tregojnë mënyrat e përfutimit të gomës në formë pllake
- Të listojnë lëndët e para kimike për prodhimin e masave plastike
- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të ngjitësave në galanteri
- Të përshkruajnë ndarjen e ngjitësave sipas origjinës
- Të listojnë vetitë e ngjitësave bimorë, shtazorë dhe sintetike.
- Të prezantojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të materialeve prej tekstili në galanteri

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për lëkurën”, kl. 12 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithëshme mbi teknologjinë e lëkurës për galanteri dhe materjaleve ndihmëse	5 orë
<b>Tema 2</b>	Lëndët e para, gjysmëprodhimet dhe prodhimet e gatëshme të lëkurës për galanteri	5 orë
<b>Tema 3</b>	Lëkura natyrale dhe teknologjia për përpunimin e saj, llojet e lëkurave të papërpunuara	8 orë
<b>Tema 4</b>	Proçeset përgatitore te përpunimit të lëkurës për galanteri	6 orë
<b>Tema 5</b>	Shtresëzimet dhe cilësitë e lëkurës	3 orë
<b>Tema 6</b>	Llojet e lëkurave tregtare dhe përdorimet e tyre në galanteri	7 orë
<b>Tema 7</b>	Lëkura kamosh, përdorimet dhe mënyrat e përfutimit të saj	3 orë
<b>Tema 8</b>	Pelçët. Njohuri të përgjithëshme	4 orë
<b>Tema 9</b>	Lëkurat artificiale dhe sintetike. Llojet dhe përparësitë e tyre ne prodhimet e galanterisë	7 orë
<b>Tema 10</b>	Masat plastike dhe goma për pjesën e poshtme të këpucëve	6 orë
<b>Tema 11</b>	Ngjitësat (bimorë, shtazorë, sintetike) që përdoren në galanteri	8 orë
<b>Tema 12</b>	Materialet tekstile që përdoren në galanteri	6 orë

#### **4. Programi i lëndës**

##### **“Njohuri në mikroekonomi”**

**(L-17-067-18)**

- **Synimet e lëndës “Njohuri në mikroekonomi”, kl. 10 - 108 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri në mikroekonomi”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë konceptet bazë si pamjaftueshmëri dhe rrallësi.
- Të identifikojnë burimet prodhuese dhe kufirin e mundësive të prodhimit
- Të identifikojnë problemin kryesor të ekonomisë.
- Të përshkruajnë veçoritë e sistemeve të ndryshme ekonomike dhe krahasojnë ato.
- Të përshkruajnë konceptet kryesore të tregut si kërkesa dhe oferta.
- Të përshkruajë rolin ekonomik të firmave dhe format ligjore të tyre.
- Të dallojë format e klasifikimit të biznesit.
- Të përshkruajë sistemin tatimor në Shqipëri
- Të dallojë strukturat e ndryshme të tregut dhe tiparet kryesore të tyre.
- Të shpjegojnë rolin dhe rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut.
- Të shpjegojnë procesin vendimmarrës për të konsumuar ose kursyer.
- Të përgatisin një buxhet personal;
- Të krahasojnë dhe evidentojnë dallimin ndërmjet kostove fikse dhe kostove të ndryshueshme (variabël).

- Të llogarisin koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale, të ardhurat e përgjithshme, marxhinale dhe mesatare, produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal dhe mesatar si dhe pikën e maksimizimit të fitimit.
- Të interpretojnë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut.
- Të shpjegojnë karakteristikat e secilës prej strukturave kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol.
- Të interpretojnë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit sipas llojeve të tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri në Mikroekonomi”, kl.10 - 108 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti i shkencës ekonomike. Faktorët e prodhimit, sistemet ekonomike dhe cikli ekonomik.	15 orë
<b>Tema 2</b>	Kërkesa, oferta, funksionimi i tregjeve dhe ekuilibri i tyre.	20 orë
<b>Tema 3</b>	Konsumatori në ekonominë e tregut	15 orë
<b>Tema 4</b>	Prodhimi, koston, të ardhurat dhe fitimi i ndërmarrjes.	24 orë
<b>Tema 5</b>	Strukturat e tregut dhe mekanizmat e rregullimit të tyre.	22 orë
<b>Tema 6</b>	Tregjet e faktorëve të prodhimit	12 orë

**5. Programi i lëndës**

**“Dendrologji”  
(L-25-140-17)**

• **Synimet e lëndës “Dendrologji”, kl. 10 - 72 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës **“Dendrologji”, klasa 10**, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë terminologjinë e fjalës Dendrologji.
- Të përcaktojnë objektin dhe rëndësinë e kësaj shkence.
- Të përcaktojnë faktorët ekologjik dhe zonat fitoklimatike
- Të përshkruajnë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve të bimëve farëzhveshura.
- Të përshkruajnë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve të bimëve farëveshura.
- Të përcaktojnë zonat fitoklimatike ku rriten dhe zhvillohen drurët dhe shkurret.
- Të shkruajnë dhe të lexojnë emrat shkencorë të drurëve dhe shkurreve.
- Të shpjegojnë kërkesat që kanë llojet pyjore për klimën dhe tokën.
- Të përcaktojnë llojet e bimëve mjeksore e industriale.
- Të përcaktojnë kohën e grumbullimit, mënyrat e ruajtjes dhe manipulimit të prodhimit të bimëve mjekësore dhe industriale.
- Të përcaktojnë vlerat e tyre dhe rëndësinë e bimëve mjekësore dhe industriale.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Dendrologji”, kl 10 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti dhe rëndësia e dendrologjisë	1 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për ekologjinë pyjore	2 orë

<b>Tema 3</b>	Bimët pyjore farëzhveshura	14 orë
<b>Tema 4</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:shelgore,arore,mështekore	10 orë
<b>Tema 5</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:ahore,vidhore,trendafilore	15 orë
<b>Tema 6</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:bishtajore,panjore,blinore	9 orë
<b>Tema 7</b>	Bimët pyjore farëveshura.Fam:ullinjore,dhe të tjera familje	17 ore
<b>Tema 8</b>	Bimet mjeksore e industriale	4 ore

## 6. Programi i lëndës

### “Hidraulikë e zbatuar” (L-03-201-11)

- Synimet e lëndës “Hidraulikë e zbatuar”, kl. 10 - 36 orë

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Hidraulikë e zbatuar”, klasa 10, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë veprat hidroteknike sipas funksionit;
- Të përshkruajë trysninë hidrostatike dhe forcën e saj;
- Të përshkruajë llojet e kapërderdhësve;
- Të përshkruajë sistemet e furnizimit me ujë dhe të rrjetit të jashtëm të kanalizimit, si dhe pjesët përbërëse të tyre;
- Të përshkruajë elementet hidraulike të një lumi, lëkundjet e reshjeve, nivelet dhe prurjet;
- Të përshkruajë sistemet e ujitjes dhe kullimit si dhe mënyrat e ujitjes e kullimit;
- Të përshkruajë veprat hidroteknike që ndërtohen për shfrytëzim të energjisë së ujit;
- Të përshkruajë llojet e digave, ujëlëshuesve, shkarkuesve dhe veprave ndërlihdhëse;

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Hidraulikë e zbatuar”, kl 10 - 36 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri për hidraulikën	2 orë
<b>Tema 2</b>	Trysnia hidrostatike dhe forca e trysnisë hidrostatike	8 orë
<b>Tema 3</b>	Regjimet e lëvizjes, rezistencat hidraulike dhe humbjet që i shoqërojnë	3 orë
<b>Tema 4</b>	Lëvizja e lëngut real dhe ekuacionet e lëvizjes së tij	4 orë
<b>Tema 5</b>	Rjedhja e lëngjeve nëpër vrima dhe hundëza dhe kapërderdhësit	3 orë
<b>Tema 6</b>	Lëvizja e njëtrajtshme dhe jo e njëtrajtshme e ujit në shtretër të hapur	4 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për njehsimin hidraulik të tubave të kanalizimit dhe të ujësjellësit	4 orë
<b>Tema 8</b>	Njohuri për sistemet e rrjetit të jashtëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	6 orë
<b>Tema 9</b>	Njohuri për hidrologjinë dhe hidrometrinë	2 orë

## 7. Programi i lëndës

**“Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”**  
**(L-35-420-16)**

• **Synimet e lëndës “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, kl. 10 – 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit” në kl.10, nxënësi duhet:

- Te klasifikojë metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës.
  - Te përshkruajë punimet përgatitore për venien e puseve në shfrytëzim.
  - Te përshkruajë venien e një pusi nxjerrje naftë në shfrytëzim
  - Te përshkruajë pajimin dhe konstruksionin e fundit të pusit.
  - Të përshkruajë përvehtësimin e puseve të naftës e gazitit.
  - Te përshkruajë përvehtësimin me metodën me ajrëzim dhe të uljes së nivelit me menyrë të ndryshme.
  - Të përshkruajë metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës dhe gazit;
  - Të përshkruajë skemën bazë teknologjike të shfrytëzimit të puseve të naftës me erupsion natyror.
  - Te përshkruajë kompletimin e puseve me erupsion natyror, koka e kolonave dhe armatura e puseve.
  - Të përshkruajë skemën bazë teknologjike të shfrytëzimit të puseve të naftës me erupsion artificial.
  - Te përshkruajë venien në punë të puseve me erupsion artificial, pajisjet e gjakës dhe valvolat e punës.
  - Të përshkruajë si bëhet shfrytëzimi periodik i puseve me erupsion artificial
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, Kl. 10-72 orë.**

<b>Tema 1</b>	<b>Metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzimi i puseve të naftës me erupsion natyror.</li> <li>• Shfrytëzimi i puseve të naftës me erupsion artificial.</li> <li>• Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompe thellesie.</li> </ul>	<b>(8 orë)</b> 3 2 3
<b>Tema 2</b>	<b>Venia e puseve në shfrytëzim:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Skema sipërfaqësore e pajisjeve të nevojshme për venien e puseve në shfrytëzim</li> <li>• Venia e një pusi nxjerrje naftë në shfrytëzim</li> </ul>	<b>(10 orë)</b> 5 5
<b>Tema 3</b>	<b>Pajimi dhe konstruksioni i pusit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompletimi sipërfaqësor i grykës së pusit</li> <li>• Pajimi nëntokesor i pusit</li> </ul>	<b>(8 orë)</b> 4 4
<b>Tema 4</b>	<b>Përvehtësimi i puseve të naftës e gazit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvehtësimi me ulje nivel</li> <li>• Përvehtësimi me ajrëzim</li> </ul>	<b>(10 orë)</b> 5 5
<b>Tema 5</b>	<b>Teknologjia e shfrytëzimit të puseve të naftës me erupsion natyror:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e pusit dhe operacionet.</li> <li>• Venia në punë e pusit dhe skema e grumbullimit.</li> </ul>	<b>(10 orë)</b> 5 5
<b>Tema 6</b>	<b>Kompletimi i sipërfaqësor dhe nëntokesor i puseve me erupsion natyror:</b>	<b>(8 orë)</b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konpletimi siperfaqesor, armature e grykes se pusit.</li> <li>• Konpletimi nentokesor</li> </ul>	4 4
<b>Tema 7</b>	<b>Teknologjia e shfrytezimit te puseve te naftes me errupsion artificial:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pregatitja e pusit dhe pajisjet e shtytjes e ajrit</li> <li>• Skema teknologjike dhe nyjet e saj.</li> </ul>	<b>(8 orë)</b> 4 4
<b>Tema 8</b>	<b>Shfrytezimi periodik i puseve me erupsion artificial:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytezimi me ngrites periodik dhe me presion</li> <li>• Sistemet e shperndarjes se agentit (gaz) ne kantjer</li> <li>• Kontrolli dhe regullimi i punes se puseve</li> </ul>	<b>(10 orë)</b> 4 3 3

## 8. Programi i lëndës

### “Shërbime mjetesh transporti” (L-18-075-15)

- Synimet e lëndës “Shërbime mjetesh transporti”, kl. 11 - 68 orë.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbime mjetesh transporti”, klasa 11, nxënësit duhet:

- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e transmisioneve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në agregatet e transmisioneve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e rrotave dhe varëseve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në rrotat dhe varëset e mjeteve të transportit;
- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e sistemeve strukturore, të drejtimit, të frenimit, të ndriçim-sinjalizimit dhe sistemet ndihmëse të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në sistemet strukturore, të drejtimit, të frenimit, të ndriçim-sinjalizimit dhe sistemet ndihmëse të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet të zëvendësimit të pjesëve në sistemet elektronike dhe kompjuterike të automjeteve

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbime mjetesh transporti”, kl. 11 - 68 orë:

<b>Tema 1</b>	Shërbimet e mirëmbajtjes në transmisionet e mjeteve të transportit	4 orë
<b>Tema 2</b>	Punime të zëvendësimit në freksionet e automjeteve	5 orë
<b>Tema 3</b>	Punime të zëvendësimit në kutinë e shpejtësisë së automjeteve	6 orë
<b>Tema 4</b>	Punime të zëvendësimit në transmisionet kardanike të automjeteve	3 orë
<b>Tema 5</b>	Punime të zëvendësimit në urat e automjeteve	5 orë



<b>Tema 6</b>	Shërbimet e mirëmbajtjes në rrota dhe sistemet varëse të automjeteve	3 orë
<b>Tema 7</b>	Punime të zëvendësimit në rrotat e automjeteve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet varëse të automjeteve	5 orë
<b>Tema 9</b>	Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet e drejtimit dhe frenimit të automjeteve	3 orë
<b>Tema 10</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet e drejtimit të automjeteve	5 orë
<b>Tema 11</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet e frenimit të automjeteve	6 orë
<b>Tema 12</b>	Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet strukturore, ndriçim-sinjalizimit dhe ndihmëse të automjeteve.	4 orë
<b>Tema 13</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet strukturore të automjeteve	3 orë
<b>Tema 14</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet e ndriçim-sinjalizimit të automjeteve	4 orë
<b>Tema 15</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet elektronike dhe kompjuterike të automjeteve.	3 orë
<b>Tema 16</b>	Punime të zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve	5 orë